

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Ardian Ajvazi dhe procesmbajtesja Valmira Sejdiu, në çështjen juridike kontestimore të inicuar me padinë e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga Ferizaj Rr. [REDAKTUAR], baza e kontestit rimbursimi i dëmit, jashtë seance me date 15.10.2015, merr këtë:

A K T G J Y K I M

-PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË/MOSBINDJES-

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, si e bazuar.

II. DETYROHET i padituri [REDAKTUAR] nga Ferizaj Rr. [REDAKTUAR], që paditëses t'ia kompensojë shumën prej **85.00 Euro (tetëdhjetë e pesë Euro)**, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 23.04.2009 rreth orës 12:30 në Ferizaj, së bashku me kamatën, e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetareve, të afatizuara për periudhë një vjeqare pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë 09.11.2013 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi e nën kërkënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja, në këtë gjyaktë ka ushtruar padi me datë 09.11.2013, kundër të paditurit, për rimbursimit të dëmit për shkak se i padituri me automjetin e tij ka shkaktuar aksident trafiku dhe e ka goditur automjetin VË Golf me targa [REDAKTUAR], pronë e Policisë së Kosovës. Paditësja ka kërkuar që padia dhe kërkesa e saj të aprovohet në tërësi si e bazuar. I padituri ka qenë i pasiguruar, pra kishte afat të skaduar të regjistrimit. Në ndërkohë i dëmtuari Policia e Kosovës nga Ferizaj ka parashtruar kërkesë tek BKS për kompenzim të dëmit dhe sipas Ligjit nr.04/L-018 Pr Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, BKS është detyruar që këtë dëm t'ia kompenzoj të dëmtuarit dhe të njejtin dëm kërkon ta rimbursoj nga shkaktari i aksidentit, tani I padituri në këtë procedurë [REDAKTUAR].

Të paditurit Gjykata i ka dërguar aktvendim për përgjegje në padi së bashku me shkresat e lëndës, i cili fakt konstatohet në bazë të fletëdërgesës për dorëzim personal se e ka pranuar me datë 26.09.2015, por i padituri [REDAKTUAR] në afatit të përcaktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi nuk ka dhënë përgjigje në padi, nëse e kundërshton apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa Gjykata nga provat e çështjes ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si duke patur parasysh faktin se i padituri ka pranuar me rregull padinë me prova dhe aktvendimin për përgjigje në padi, Gjykata bazuar në nenin 150.6 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjygjëse. I padituri ka qenë i detyruar që mbrenda afatit 15 ditësh pas pranimit të të njejtit të jep përgjigje për pretendimet e paditëses, por të njejtin afat e ka lëshuar dhe nuk ka dhënë përgjigje dhe deri me sot kanë kaluar 20 ditë.

Paditësja, Gjykatës i ka bashkangjitur provat dhe dëshmitë tjera materiale për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar në shumën prej 85.00 Euro.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësin për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamaten ka vendosur në bazë të nenit 378 të LMD-së.

Gjykata ka obliguar të paditurin për kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në bazë të nenit 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.711/13, me datë 15.10.2015

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFJUISHËM
ODLUKA JE PRAVNOBNANA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
Dana 26.11.2015

[Signature]

Gjyqtari,

Ardian Ajvazi

[Signature]

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate. Afati fillon nga dita e nesërme nga pranimit i këtij Aktgjykimi.